



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:084225

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05368867

P.nr.161/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurve: Sh.E nga komuna e Vitisë dhe A. J. nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në ...-Shkup, të akuzuar për veprën penale, në bashkryerje dhe në vazhdimësi, Detyrimi në tentativë nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31, 77 dhe nenin 28 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.240-12/20 të datës 13.07.2020, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt.18.01.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Avdulla Abedini, të dëmtuarit N.B. dhe të pandehurve me mbrojtësit e tyre me autorizim, av.F.Sh.dhe av.U. B., , me dt.23.012024 mori dhe shpalli , ndërsa me dt.22.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.Sh.E nga komuna e Vitisë, rr.”...”pn, i lindur më dt. ..., nga i ati Sh... dhe e ëma N..., e gjinisë H..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves , i martuar prind i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar , i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal : ...

2.A. J. nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në ...-Shkup, rr....., i lindur më dt. ..., nga i ati Xh... dhe e ëma A..., e gjinisë K..., shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut , i

martuar prind i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa,punë i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. të dokumentit identifikues :

JANË FAJTORE

Sepse, prej kohës së papërcaktuar pas datës 06.09.2019 deri më dt.27.01.2020 rreth orës 09:54 min.i pandehuri Sh.E, në marrëveshje dhe në bashkëveprim me të pandehurin A. J., në vazhdimësi dhe me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm për vete, kanë tentuar që përmes forcës dhe kanosjes serioze t'a detyrojnë të dëmtuarin N.B, që të veprojë në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që disa ditë pas arritjes së marrëveshjes dhe nënshkrimit të kontratës mbi ndarjen e asetëve biznesore të ndërmarrjes me dt.06.09.2019, me të cilën i dëmtuari N.B e kishte ndërprerë raportin afarist me të pandehurin A.J, i pandehuri Sh.E, shkon në zyrën e dëmtuarit, ku prezent ishte edhe A.J, dhe pasi që i pandehuri Sh..., nga qanta e tij e krahut nxjerr një revole në tavolinë, i drejtohet të dëmtuarit N.B me fjalët “kam ndëgjuar nga ky zotëria, (duke aluduar në të pandehurin A...) se jeni në procesin e ndarjes, ky zotëria A..., me ka marrë pare borgj 50.000 € dhe duke e drejtuar gishtin nga njëra nga makinat në fabrikë, thot se qajo maqina e cila e ka vlerën 60.000 €, është e jemja dhe mos gabo me prek”, ndërsa me dt.27.01.2020 i pandehuri Sh..., përmes telefonit me nr...., e thërret të dëmtuarin N.B, dhe i thot: “a i ke mbledh punëtortë te fabrika, se unë du mi pa aty dhe zyrën tënde aty në fabrikë me ma liru, ose vij me bager ti nxjerr maqinat, se s'ja ke ble ti maqinat A.Jt” dhe kërkon që të jetë prezent sa herë që i dëmtuari të bisedojë me të pandehurin A..., derisa me dt.01.02.2020, pasi që i dëmtuari i kishte dërguar shkresën për marrëveshje të pandehurit A..., i pandehuri Sh... ishte shprehur ndaj të dëmtuarit me fjalët “unë vendosi për këtë punë, dhe me dt.01.02.2020 bëhem ortak me juve, dashte ti apo nuk dashte”. Ndërsa i pandehuri A... me dt.31.12.2019, përmes telefonit e kishte kontaktuar të dëmtuarin N.B, duke i thënë me ton urdhërues “lemi qelsat në fabrikë se kam me pru do landë të parë aty” edhe pse me marrëveshje me shkrim, i pandehuri A...dhe i dëmtuari, ishin pajtuar që nëse të dëmtuarit i paraqitet ndonjë problem teknik rreth tërheqjes së mjeteve nga fabrika në fsh... të dëmtuarit t'i ipet afat afat shtesë, pra për tërheqjen e mjeteve të punës nga fabrika.

Me këto veprime, të pandehurit në bashkryerje dhe në vazhdimësi, kanë kryer veprën penale, Detyrimi në tentativë nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31, 77 dhe nenin 28 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,48,49,69,70 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, i

G J Y K O N

Të pandehurin Sh. E., me dënim me gjobë në shumë prej 1500.00 € (njëmijë e pesëqind euro) dhe me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 12 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej dy viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Të pandehurin A.J, me dënim me gjobë në shumë prej 1000.00 € (njëmijë euro) dhe me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 18 mujave, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Të pandehurit, secili veq e veq, janë të obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajnë ne afatin prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe ate në dy këste mujore, në të kundërtën , gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohen të pandehurit, secili veq e veq, që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë pranë kësaj gjykate, shumën prej 50.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimin shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

I dëmtuari N.B, nga Kaçaniku, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.240-12/20 të datës 13.07.2020, të pandehurit Sh.E nga komuna e Vitisë dhe A.J nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në Saraj-Shkup, I ka akuzuar për veprën penale, në bashkryerje dhe në vazhdimësi, Detyrimi nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze, gjykata caktoi dhe mbajti senacën e shqyrtimit fillestar me dt.21.06.2020, me të cilin rast pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori I shtetit, të pandehurit, nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen.

Në shqyrtimit gjyqësor të mbajtur pranë kësaj gjykate, prokurori I shtetit Avdulla Abedini në fjalën e tij deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime. Në fjalën e tij përfundimtare, të prezentuar me shkrim, ndër të tjera, theksohet se, pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mire se të pandehurit e kanë kryer veprën penale si në aktakuzë. Gjendja faktike është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit N.B, në cilësi të dëshmitarit, I cili ka deklaruar se me të pandehurin A.J, kanë qenë bashkëpronar në kompaainë “...” me pjesëmarrje në aksione secili me nga 50 %, dhe gjatë kësaj kohe kanë punuar së bashku, dhe meqenëse I pandehuri A... ka qenë udhëheqës I prodhimit , kishte ndërmarrë disa veprime, për të cilat nuk ishte pajtuar I dëmtuari N.B. Me dt.06 shtator 2019, I dëmtuari dhe I pandehuri A... dakordohen që të bëjnë ndarjen e asetëve të këtij biznesi në raportin 50 me 50 , përmes kontratës me shkrim të noterizuar. Pas kësaj, I pandehuri Sh... kishte shkuar në zyrën e të dëmtuar, dhe pasi që ishte prezentuar I kishte thënë të dëmtuarit” kam dëgjuar se jeni ndarë me biznes dhe se A... I ka disa obligime ndaj meje”. Pas kësaj, I pandehuri Sh..., prapë kishte shkuar te fabrika duke I thënë të dëmtuarit, “ ajo makinë që është atje, duke e drejtuar gishtin nga njëra nga makinat në fabrikë, mos gaboni me prek se është imja, se A... mi ka borgj 50.000 €, dhe e ka vendosur dorën në qantën të cilën e mbante në krah, në të cilën kishte një revole të cilën e ka nxjerrë dhe prezent ishte edhe I pandehuri A..., derisa I dëmtuari e kishte njoftuar të pandehurin Sh..., se nuk është I njoftuar për këtë borgj, dhe kishte kërkuar nga I pandehuri Sh... që të mos përzihet në ndarjen e asetëve dhe duke e ndier veten të kërcënuar. Pas një kohe të shkurtër, I pandehuri Sh... prapë e kishte thirr në telefon të dëmtuarin, dhe ishte shprehur me fjalët”a po I heq maqinat nga fabrika ose ka me ardh em bager që ti heq I ti njerr në rrugë”, ndërsa I dëmtuari kishte kërkuar sqarim nga I pandehuri A..., lidhur me borgjin e pretenduar nga I pandehuri Sh..., për çka I pandehuri A... I cili kishte pranuar borgjin ndaj të pandehurit Sh..., prandaj I dëmtuari e kishte ndier vetn të kërcnuar dhe shantazhuar nga të pandehurit dhe ishte detyruar që t’I largojë makineritë nga objekti. Këtë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe dëshmitari Q. B., I cili poashtu ka pohuar faktin se I dëmtuari dhe I pandehuri A..., për shkak të mosmarrëveshjeve, janë dakorduar që me marrëveshje me shkrim, të ndajnë asetet e kompanisë “...”, mirëpo nga I dëmtuari-babai I tij ishte njoftuar se I pandehuri Shqip e kishte thirr në telefon dhe I kishte thënë se “jam tu ardh me vëllezër, a mi ke ba puntortë gati dhe kam me ardh me t’I hjek makinat me bager dhe me t’I qit jashtë objektit, se I vyn objekti, dhe pas këtij presioni janë detyruar t’I largojnë makinat nga objekti dhe pse sipas marrëveshjes interne kishin afat deri me dt.31.01.2020. Dëshmitarja M. G., ka deklaruar se pas ankesës së të dëmtuarit, kishte paraqitur kallëzim penale ndaj të pandehurit Sh...për veprën penale, Detyrim dhe veprën penale, Kanosje. Prokurori I shtetit në fjalën e tij përfundimtare, poashtu ka kërkuar nga gjykata që mbrojtjes së të pandehurve, pjesërisht duhet t’u fal

besimin, mirëpo pjesës së deklaramit të tyre, ku ata mohojnë veprimet e tyre të cilat paraqesin elemente të veprës penale, most u fal besimin, meqë të njejtit me këto deklarime, tentojnë t’I shmangen përgjegjësisë penale. Prandaj edhe ka kërkuar nga gjykata, që të pandehurit t’I shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohen dhe t’u shqiptojë sanksion penale me të cilin do të arrihet qëllimi I dënimit, duke patur parasysh si rrethanë rënduese motivin e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, ndërsa rrethana lehtësuese nuk u gjetën.

I dëmtuari N.B, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor I bashkangjitet ndjekjes penale dhe ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, duke shtuar se dëmi I shkaktuar për te kalon vlerën mbi 150.000 euro, duke shtuar se ka patur edhe dëm psikik, emocional për shkak të provokimeve me anëtarë të familjes, të cilat nuk mund të falen asnjëherë. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të marrin vendim për dënimin e merituar sipas ligjit në fuqi, duke theksuar se i kundërshton të gjitha përgjigjet e të akuzuarave të dhënat gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat kanë qenë të njëanshme dhe jo reale dhe nuk përkojnë me gjendjen faktike dhe vlerëson se në rastin konkret ka përzierje –ndërhyrje të një personit të tretë pa asnjë autorizim dhe pa asnjë marrëveshje dhe gjitha këto, I njejt vlerëson se janë të iniciuara nga I pandehuri A..., i cili me çdo kusht ishte përpjekur që t’a shkatërrojë biznesin nga i cili ka ngrënë bukë 20 vite. Nuk është e vërtetë që une e kame autorizuar te pandehurin Sh... per te nderhyr ne mes meje dhe A...t dhe per derisa ne i kemi zgjedhur problemet me A... ne menyrr ma te mir , ky ka ardh ne zyrën tone bashke me A... dhe thot se zotri a je i njoftum qe A... mu mi ka borgj 50000 euro dhe une i kame than se jo une nuk kame i njoftum dhe jo 17000 ashtu siq e thot i pandehuri . dhe me marveshjen e 06.09.2019 jemi marr vesh qe te gjitha borgjet qe i ka marr A... pa dijenin time i perkasin A...

Mbrojtësi I të pandehurit Sh. E. av. Fitim Shabani, në fjalën e tij përfundimtare të përpiluar me shkrim, ndër të tjera ka theksuar se, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, me asnjë prove të vetme nuk është vërtetuar se I mbrojturi I tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, meqë edhe nga vetë deklarimi I të dëmtuarit N.B, sa I përket pretendimit të tij (të dëmtuarit) se I mbrojturi I tij I kishte thënë se “kam dëgjuar se jeni në process të ndarjes , ky zotëria, A... më ka marrë borgj 50.000 €dhe që maqina e cila ka vlerë prej 60.000 €,është e imja dhe mos gabo me prek”e me të cilin rast vetë I dëmtuari N.B ka deklaruar se I ka thënë të pandehurit Sh...” t’I nuk ke asnjë të drejtë këtu me u përzi”tregon se në rastin konkret nuk ka asnjë formë të detyrimit, aq më shumë që I njejt, pra I dëmtuari, në pyetjen e mbrojtësit ka deklaruar se “nuk e kam të qartë se për cilë maqinë e ka patur fjalën, (I pandehuri Sh...) se ka bërë me gishte nga një pjesë ku kanë qenë disa maqina” dhe poashtu në pyetjen e mbrojtësit I dëmtuari ka theksuar se “as që nuk I kam marrë shumë serioz këtë fakt, por esenca ka qenë se pse ky është përfshirë si pale e tretë pa patur document dhe autorizim për këtë punë dhe nuk më ka interesu cila është makina”. Poashtu sa I përket pretendimit se I pandehuri Sh... ka kërkuar që të hyjë si ortak I dhunshëm në kompaninë ku N... dhe A... kanë qenë bashkëpronarë, I dëmtuari në pyetjen e prokurores ka theksuar se “pretendim I tyre, pra Sh...t dhe A...t, mirëpo nuk e ka

pranuar si ortak Sh...n në kompani dhe as që ka qenë temë kjo”shtrohet pyetja cili ka qenë detyrimi në këtë rast, duke patur parasysh edhe faktin që I dëmtuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në pyetjet e parashtruara, ka është përgjigjur se “jo absolut nuk I ka përfillur kërkesat e të pandehurit Sh..., sepse të gjitha marrëveshjet ne I kemi bërë me bashkëpronarin A...n”. Lidhur me pretendimin e të dëmtuarit, se ky I fundit për shkak të presionit të pandehurve, është zhvendosur në Ferizaj, mbrojtësi ka potencuar se, I dëmtuari edhe përkundër marrëveshjes , objektin e kishte mbajtur për gjashtë muaj, ani pse ishin marrë vesh për tre muaj, por edhe sikur nga I dëmtuari të ishte kërkuar që të zhvendosej më pare, kërkesa e tillë do të ishte legjitime. Mbrojtësi, poashtu pretendon se me deklaratën e dëshmitarit Q. B., ku I njehti ka folur për ndërmjtësimin e tij dhe të pandehurit Sh..., mes të dëmtuarit dhe të pandehurit A..., pasi që këta të fundit kishin prishur raportet fariste mes tyre, si rezultat I të cilit është arritur marrëveshja për të punuar secili prej afaristëve në tri ditë të ndara në të njejtën fabrikë, është konstatuar se këto kanë qenë problem biznese që ka patur I dëmtuari me të pandehurin A..., dhe se ky dëshmitar asnjëherë nuk ka pretenduar se I pandehuri Sh... , të ketë pretenduar që të jetë aksionar I dhunshëm, e as që ka patur ndonjë interes të tillë, meqë kompania ka qenë në kollaps dhe cili ka qenë interesi që I mbrojturi I tij të bëhet aksionar në një kompani që ka falimentuar.prandaj nga këto deklarime nuk është vërtetuar asnjë fjalë e aktakuzës, derisa nga mbrojtja e të mbrojturit të tij është konstatuar se ndërmjet këtij të fundit dhe të dëmtuarit nuk ka ekzistuar asnjë mosmarrëveshje , derisa mosmarrëveshjet afariste biznese me të dëmtuarin, nuk kanë qenë asnjëhere në ndonjë formë të detyrimit. Mbrojtësi, në fjalën përfundimtare të prezentuar me shkrim, poashtu duke ju referuar dispozitës ligjore, bazë për formësimin e kësaj veprë penale është që “ kushdo që e përdor forcën apo kanosjen serioze me qëllim të përfitimit të pasurisë për vete apo tjetrin” derisa në rastin konkret cila është forca apo kanosja e përdorur ndaj të dëmtuarit nga të pandehurit, aq më shumë kur në rastin konkret ka qenë edhe vetë djali I të dëmtuarit ndërmjetës ndërmejt palëve për zgjidhjen e problemeve biznese. Mbrojtësi poashtu thekson se, sa I përket figures së veprës penale, nëse I referohemi komentarit të KPRK-së, lidhur me këtë veprë penale, pikes nr. 14, është interpretuar dhe këtë e thot edhe dispozita se nuk mund të ketë veprë penale të detyrimit, nëse I dëmtuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në dëm të pasurisë së tij, pavarësisht prej përfitimit nga pala tjetër, e që nisur nga këto rrethana, cili do të konsiderohej detyrim kur I dëmtuari thot”unë të pandehurin Sh... s’e kam përfillur fare, unë me te s’jam marrë vetëm pse më ka penguar pse me fol pa autorizim, unë absolutisht nuk kam vepru siq ka kërku tani I pandehuri”, pra si do të kryhej vepra e detyrimit derisa I dëmtuari I thot këto fjalë. Prandaj mbrojtësi I të pandehurit Sh. E., bazuar në theksimet e cekura në fjalën përfundimtare, I ka kërkuar gjykatës që I mbrojturi I tij të lirohet nga akuza, meqë nuk është vërtetuar se I njehti nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi I të pandehurit A.J, av. U. B., në fjalën e tij përfundimtare të përpiluar me shkrim, ndër të tjera ka theksuar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua që I mbrojturi I tij e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, dhe kjo vërtetohet edhe nga vetë deklarimi I të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit, I cili ka sqaruar raportet që ka patur me të mbrojturin e tij, gjatë

bashkëpunimit dhe pas ndarjes, duke mos provuar asnjë nga pretendimet e prokurorisë. Kjo për faktin se , I dëmtuari në asnjë moment nuk ka mundur që të vërtetojë që I pandehuri A..., e ka detyruar që të ndërmerri ndonjë veprim të caktuar nën detyrim, trysni apo kanosje, por të gjitha pretendimet e tij janë se supozuara, duke aluduar se I pandehuri A... ka menduar të bëjë këtë dhe atë, derisa në pyetjet e prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor, I dëmtuari është përgjigjet se “Kjo ka qenë pretendim I tyre, duke l’u referuar Sh...t dhe A...it, mirëpo edhe përkundër kësaj nuk e kam pranuar si ortak Sh...n të hyj në kompaninë time dhe kjo nuk ka qenë tema”. Një ndër presionet që ka përmendur I dëmtuari është telefonata që I ka bërë I pandehuri A..., duke I thënë që “sa më shpejt mi hjek maqinat se I kam puntë e mija”e që nga kjo nuk mund të arrihet në përfundim që ka patur detyrim nga I pandehuri A..., sepse me këtë ky I fundit vetëm ka kërkuar që të zbatohet marrëveshja e lidhur mes tij dhe të dëmtuarit, për transferimin e mjeteve nga fabrika dhe kjo, bazuar në deklarin e të dëmtuarit, ka ndodhur rreth tetë muaj, dpasi që janë dakorduar për ndarjen e asetëve të kompanisë. Se I mbrojturi I tij nuk e ka kryer veprën penale, nuk është vërtetuar as nga deklarata e dëshmitarit Q. B., qoftë për ortakëri të dhunshme qoftë për telefonatën e dt.31.12.2019, përmes së cilës pretendohet se I mbrojturi I tij I ka bërë presion të dëmtuarit për lirimin e fabrikës, e që në fakt kjo, bazuar në marrëveshjet e tyre për operim ne tri ditë të ndara në të njejtën fabrikë, ka qenë një kërkesë legjitime e të mbrojturit të tij, në rastin konkret lidhur me qelësat e fabrikës në fjalë. Mbrojtësi konsideron se në rastin konkret, më shumë kemi të bëjmë me pakënaqësi rreth ndarjes apo funksionimit para apo edhe pas ndarjes sëasetëve për operatorin ekonomik në bashkëpronësi, sesa për përmbushjen e ndonjë elementi të ndonjë vepre penale, meqë dëshmitari në vazhdimësi potencon faktin që prindi I tij ka patur presion me kërkesë legjitime të ish bashkshortit I cili ka kërkuar vetëm zbatimin e marrëveshjeve dhe asgjë tjetër. I pandehuri në mënyrë të detajuar ka përshkruar procesin para dhe pas ndaarjes së asetëve me ortakun e tij, duke vlerësuar se të gjitha kërkesat në raport me të dëmtuarin, lidhur me operatorin ekonomik kanë qenë legjitime dhe me të vetmin qëllim që t’a zbatojnë marrëveshjen e tyre dhe se asnjëhere nuk I ka bërë presion me qëllim që I dëmtuari të vendoset në shtate që të veprojë në dëm të tij, duke përsëritur që të gjithja takimet kanë patur për qëllim zgjidhjen e raportit afarist mes tyre.Prandaj, mbrojtësi vlerëson se në rastin konkret, në mes të mbrojturit të tij dhe të dëmtuarit, mund të ketë ndonjë paqartësi në raport me ndarjes e asetëve, e që nga kjo mund të hapet ndonjë contest civilo-juridik, I cili do të duhet të trajtohej në Gjyaktën Civile. Andaj mbrojtja konsideron se, aktakuza në fjalë është krejtësisht e pabazuar dhe e pambështetur në asnjë provë materiale dhe procedurale, andaj I ka propozuar gjykatyës që të mbrojturin e tij, në mungesë të provave, t’a lirojë nga përgjegjësia penale.

I pandehuri Sh.E., në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se, në rastin konkret vetëm, me ndihmën edhe të Q. B, vetëm ka ndërmjetësuar me I ul tensionet në mes të N... dhe A...t, dhe si rezultat është arritur një marrëveshje për të punuar secili nga tri ditë të javës, mirëpo e njejtja nuk është ekzekutuar, dhe pastaj është thirr nga policia për t’u deklaruar lidhur me ankesën e të dëmtuarit. Pranon se e kishte

thirr me telefon të dëmtuarin, nga I cili kishte kërkuar ekzekutimin e marrëveshjes, me të cilin rast I dëmtuari kishte filluar që të arsyetohej se nuk ndëgjohet mire në telefon, dhe pastaj I pandehuri I kishte thënë se “ ti e di me mire se çka ban, por me kujtohet shumë mirë që më ke thënë se unë e respektoj marrëveshjen dhe nëse nuk e rrespektoj une kam mi nxjerr makinat me bager prej aty” dhe kjo bisedë është bërë në perezencë të djalit të të dëmtuarit, Q.... I pandehuri më tutje ka shtuar se, në kohën për të cilën bëhet fjalë, nuk ka patur interesim që të bëhet aksionar, meqë e ka ditur mire dhe ka patur fakte që kompania në fjalë ka patur rreth dy million euro borgj, pastaj edhe për faktin që I njejtë ka patur edhe kompaninë e tij, dhe nuk e ka parë të nevojshme që të bëhet aksionar dikun tjetër, nuk e pranon faktin që I ka thënë të dëmtuarit se “ unë vendosi për këtë punë, dhe me dt.01.02.2020 bëhem ortak me juve, dashte ti apo nuk dashte”. Thekson se A...i dhe N..., për dy vite me radhë I kanë shfrytëzuar dy makina të tij, pa kurrfarë interesi, vetëm u’a ka lënë në shfytëzim si shokë dhe bëhet fjalë për makinat, Reks dhe Handman, për çka para gjykatës prezentoj kontratën e shitblerjes së dt.10.10.2019, të cilat edhe I ka kërkuar nga I dëmtuari. Nuk e mohon faktin që ka komunikuar me telefon me të dëmtuarin, por jo në formën siq ceket në aktakuzë, por përsërit faktin se qëllimi I telefonatës ka qenë realizimi I marrëveshjes për punën e përbashkët në fabrikë. I njejtë në mbrojtjen e tij ka shtuar se të dëmtuarin e ka njohur më herët, për çka prezanton para gjykatës një fotografi të një ndeje e mbajtur në muajin janar të vitit 2018, ku prezent ka qenë edhe I dëmtuari, dhe nuk është e vërtetë ajo që e thot I dëmtuari, se nuk është njohur më pare me të pandehurin Sh....qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurori, pranon se gjatë vitit 2020 e ka përdorur numrin e telefonit 049/122-100. Ka qenë në dijeni se në kompaninë “...” janë bashkëpronarë I pandehuri A... dhe I dëmtuari me 50 % të akcioneve, ndërsa vetë nuk ka qenë ndonjëherë ortak apo aksionar ne kompaninë në fjalë, dhe I dëmtuari në emër të Kompanisë I është detyruar me një borgj prej 17.000 €, për të cilin nuk ka ndonjë document me shkrim, por u’a kishte dhënë si mik, dhe ishte borgj I përbashkët I të pandehurit A... dhe të dëmtuarit. E mohon që përmes telefonatës së dt. 27.01.2020 ishte shprehur me fjalët “a i ke mbledhur punetoret te fabrika se une du mi pa aty dhe zyrën tende aty ne fabrike me ma liru ose vij me bager ti nxjerri makinat se ti sja ke ble A... “ duke sqaruar se I kishte bërë pyetje rreth realizimit të marrëveshjes paraprake, duke I thënë se “a jeni duke e zbatu marrveshjen a jeni duke i ndar puntort me A...ashtu siq jeni marre vesh .

Ka qenë në dijeni që i pandehuri A... dhe i dëmtuari N.B kanë patur mosmarrëveshje rreth menagjimit të kompanisë, për faktin që ata vetë I kishin rrëfyer të pandehurit Sh... për problemet që ata I kishin mes vete, dhe kështu e kishte kuptuar se ishin në proces të ndarjes së asetëve, por që nuk ka qenë I angazhuar në këtë pjesë, ndërsa për ndërmjetësim e kishte angazhuar vetë I dëmtuari. Në periudhën kohore prej dates 06.09.2019 deri me dt.27.01.2020 ka qenë disa here në zyrën e kompanisë “...” meqë kanë qenë miq, por nuk pranon se I ka thënë fjalët” kame ndëgjuar qe jeni ne procesin e ndarjes, ky zotrija A... me ka marrë borgj 50.000 €, e qajo maqina e ka vlerën 60.000 €, është e imja dhe mos gabo me prek “ . I pandehuri poashtu ka theksuar se makinat, për të cilat pretendon se kanë qenë të tij, I kishte blerë prej K. A. me herët se data dt.10.10.2019, por që kur e ka vërejtur se I pandehuri A... dhe I

dëmtuari nuk po shkojnë mirë mes vete, ka bërë kontratë me shkrim me K.A lidhur me këto dy makina, dhe këto makina kanë qenë në shfrytëzim për dy vite me radhë nga I pandehuri A... dhe I dëmtuari, meqë paraprakisht pronar ka qenë K.A, e pastaj kur janë bërë pronarë I pandehuri A... dhe I dëmtuari, I pandehuri Sh... thot se I kishte lënë në fabrikë në shfrytëzim të pronarëve, A...it dhe N..., I pandehuri Sh... në mbrojtjen e tij poashtu ka theksuar se, marrëveshja për zhvendosjen e të dëmtuarit nga fabrika është arritur pas 2 apo tre muajve pas dates 06.09.2019, dhe ka vlerësuar se, meqë ka qenë I angazhuar si ndërmjetësues, nuk është që ka kërkuar llogari nga I dëmtuari, përmes telefonatës së dt.27.01.2020, por thjeshtë I ka bërë pyetje të dëmtuarit se a don me zbatu marrëveshjen për të punuar secili me nga tre ditë, pra I pandehuri A... me të dëmtuarin.

I pandehuri A... Jakupi, në fjalën e tij në shqyrtim gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, në mbrojtjen e tij ka theksuar se i njuh palët në procedurë Sh... dhe N..., ashtu që derisa N... e ka patur dhe e ka ortak në kompaninë “...” ndërsa Sh...n e ka shok dhe me te cilin njihen edhe me herët . Me N... kishte filluar bashkëpunimin si ortak në vitin 2017, por për shkak të problemeve financiare dhe që duke mos parë perspectivë të mire në këtë biznes, në vitin 2019 kanë vendosur që t’a ndajnë kompaninë, dhe pastaj janë dakorduar që të punojnë në tri ditë të ndara secili veq e veq, por që nuk është zbatuar as kjo marrëveshje, dhe I dëmtuari ka vazhduar me biznesin deri sa është transferuar prej aty. Sqaron se, N.B ka punuar në adminstratë,ku është marrë edhe me pjesën financiare, ku kanë punuar edhe bashkshortja dhe djali I tij, derisa ai pra I pandehuri A... është marrë me pjesën e prodhimit, dhe një pjesë të furnizimit me lëndë të parë. I njeti poashtu ka sqaruar propozimin e N..., me të cilin ky I fundit kishte kërkuar 200.000 € nga I pandehuri A..., për të vazhduar me biznesin më tutje, por që I pandehuri A... I kishte treguar se nuk mund të sjell më shumë para në këtë biznes dhe prej kësaj dhe bisedave tjera me të dëmtuarin e kishte kuptuar që nuk kishte alterantivë tjetër pos që dikush të bëjë blerjen e aseteve. Pranon se marrëveshja e dt.06.09.2019 është arritur edhe me vullnetin e tij të plotë, por që e njejta nuk është zbatuar, as sa I përket punës me nga tri ditë në fabrikë dhe as nuk I janë dorëzuar automjetet si në pikën III të kontrates, dhe kontribut për arritjen e marrëveshjes në fjalë ka dhënë përveq Q..., djalit të N..., edhe vëllau I të pandehurit A..., S... por edhe I pandehuri Sh..., me pëlqimin e të dëmtuarit N.B, dhe pas kësaj marrëveshje janë arritur edhe disa marrëveshje tjera gojore, derisa I dëmtuari Nafi, pas rreth 6 muajve e ka liruar objektin e fabrikës. në të cilin pas marrëveshjes me shkrim kishte operuar vetëm N... Pranon se me dt.31.12.2019 e kishte telefonuar N..., nga I cili kishte kërkuar që t’a lirojë objektin dhe e kishte pyetur se a kishte arritur që t’I transferojë mjetet nga objekti I fabrikës në fsh.... në Ferizaj, dhe pas kësaj më nuk e ka telefonuar apo takuar N..., deri kur është prishur kontrata për qiranë e objektit në janar ose shkurt 2020 saktë nuk I kujtohet, dhe në periudhën kohore, pas arritjes së marrëveshjes për ndarjen e aseteve, askush nuk I ka bërë presion N... që të largohet nga objekti, pork a qenë vendim I tij që të operojë në Ferizaj. Pohon se bashkë me të dëmtuarin-nafinë, të pandehurit Sh... I kanë patur borgj 17.000 €, dhe se makinat Reks dhe Handman kanë qenë prone e të pandehurit Sh..., me të cilin , pas daljes së N... nga objekti kanë vazhduar biznesin bashkë në fsh.

Seqishtë Hani Elezit. Nuk e mohon faktin se , në kohën pas arritjes së marrëveshjes se dt.06.09.2019, kur bëhej fjalë për punën tri ditë me tri për secilin, kanë kërkuar një zyre në fabrikë për te dhe të pandehurin Sh..., meqë ky I fundit I kishte dy makinat e lartëcekura në fabrikë dh I kishim borgj 17.000 €. Mohon se ka ndëgjuar të pandehurin Sh... t'I ketë thënë të dëmtuarit N... “ se a i ke mbledhur punëtorët te fabrika se une du mi pa aty dhe zyrën tënde në fabrik me ma liru ose vi me bager t'i nxjerri maqinat, se ti sja ke ble maqinat A.Jt “

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve: N.B dhe Q.. B., si dhe me adminstrimin e provave materiale si: leximin I kontratës së datës 06.09.2019 mbi ndarjes e asetëve të Ndërmarrjes të “...” e noterizuar me vërtetimin ... në zyrën e S.Sh., deklaratën e të pandehurit Sh. E të dhënë në polici me dt.29.01.2020 dhe prokurori me dt.26.06.2020, deklaratën e dëshmitarit Q..B në prokurori me dt.09.07.2020, deklaratën e të dëmtuarit N.B në Prokurori me dt.10.07.2020, dokumentet statutore të fabrikës “...” nga Hani Elezit, mesazhet telefonike të bisedës mes të pandehurit Sh.E dhe dëshmitarit Q. B..

I dëmtuari N.B në cilësinë e dëshmitarit, në dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor deklaroi se që nga viti 2017, kanë filluar bashkëpunimin me A.J si bashkëpronarë në “ ... “, gjatë të cilit, pasi që I pandehuri A... ka kontraktuar vetëm gojarisht marrëveshje me furnitorë për furnizim me lëndë të parë, të cilat i dëmtuari I ka konsideruar të palogjikshme, prandaj edhe është menduar bashkëpunimi I mëtutjeshëm mes tyre, derisa me dt.06.09.2019 kanë arritur marrëveshjen me shkrim për ndarjen e asetëve të fabrikës në fjalë me 50-50. Në ndërkohë, një ditë tjetër,në zyrën e të dëmtuarit kishte shkuar i pandehuri Sh... I cili duke I drejtohet të dëmtuarit me fjalët “ zotëri une jam filani kështu kështu se, A... me ka obligim mua dhe kom marr vesh se jeni te nda fabrikën nuk dihet se a te ka njoftuar A... ju a po jo dhe ky ka marr obligimin per punët e veta dhe se ajo makina qe eshte atje duke drejtuar gishtin nga njëra makin mos gaboni me prek “ , derisa I dëmtuari I kishte thënë të pandehurit Sh..., se “A... të ka marr borgj ty dhe nuk ki asnjë të drejtë me u përzi ne ndarjen e asetëve të kësaj fabrike” , Të nesërmen e thërret në telefon I pandehuri Sh... dhe I thot “N...zotria, mi qet puntortë në oborr ren dhe bëjmë selektimin e tyre” , dhe nuk e di sakt a ka qene e njëjta ditë apo një ditë tjetër e ka bërë edhe një telefonatë tjetër Sh..., dhe thot “zotëri a po i tërheq maqinat prej aty apo po vij me bager me t'i nxjerr ne rrugë”, dhe kjo sjellje e tij, I dëmtuari vlerëson se është inicuar dhe përkrahur nga I pandehuri A..., I cili edhe në këto rrethana ka qëndruar në heshtje, ndërsa I pyetur nga I dëmtuari për pretendimet e të pandehurit Sh..., I pandehuri A... kishte pranuar që kishte marrë borgj nga I pandehuri Sh..., e për të cilat nuk kishte ditur I dëmtuari. I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, në dëshminë e tij ka theksuar se ka qenë pretendim I Sh...t dhe A...t, që Sh... të hujë si ortak në kompaninë e tij, mirpo edhe përkundër saj nuk e ka pranuar si ortak Sh...n dhe as që ka qenë temë kjo, edhepse Sh... kishte shkuar dy-tri here në fabrikë, I paftuar, me një qantë në krah duke e qel dhe treguar se ka diqka aty, për të dëmtuarin kjo ka qenë kërcënuese. Ka pranuar si të sakta fjalët e thëna në prokurori si në vijim “ Me kujtohet se Sh... e ka

pasur një qante te mesme krahu nga e cila ka nxjerr një revole ne ate raste me ka thene se kam dëgjuar se je ne procesin e ndarjes ky zotria A... me ka marr oare borgj 50 mije dhe se ajo maqina e ka vlerën 60mij eshte e jemja dhe mos gabo me prek”. I dëmtuari, poashtu ka theksuar se nuk e ka marrë si shumë serioze, kete fakt por esenca ka qenë se pse ky (Sh...) është përfshirë si palë e tretë pa patur asnjë dokument dhe autorizim për kete dhe nuk është që I ka interesuar shumë se cila është makina të cilës ju ka referuar I pandehuri Sh..., prandaj edhe nuk e ka përfill kërkesën e këtij të fundit. Të cilin thot se e ka njohur prej momentit kur ka ardh në zyre bashkë me A...n, pas ndarjes së aseteve me marrveshjen e dt.06.09.2019, dhe vetë ardhja në zyre e tij, pastaj telefonata e mëngjesit e të pandehurit Sh... me fjalët “duhet mi qitë puntorët në oborr, se une mirrna vesh me to” telefonata tjetër me fjalët” mos shko në fabrikë se puna është shumë keq” këto fjalët e fundit I sihin thënë nga I pandehuri Sh... në Viti, ku prezent kan qene dy vëllezërit e tij , një shok i dëshmitarit nga Ferizaj dhe vetë dëshmitari, pastaj hapja e qantes, nxjerrja e revoles dhe reklamimi, pastaj fjalët “ a pi nxjer makinat me shlu fabrikën se përndryshe na vijm me i nxjerr me bager “ për të dëmtuarin kan qenë presion, prandaj edhe e ka lajmëruar policinë. Pas kësaj, me ish bashkëpunëtorët e tij, M...dhe K. A., në presence të pandehurit A... janë marrë vesh që Brenda tre muajve t’ a lëshojë fabrikën, me mundësi shtyerje për 1 ose 2 muaj, mirëpo A..., edhe përkundër kësaj nuk e ka ndal presionin, që sa me shpejt t’a lëshojë lokalin, derisa lokalin e kishte liruar në muajin shkurt apo mars të vitit 2020.

Dëshmitari Q. B., në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, prindi I tij N..., ka qenë ortak në një biznes me A.J, në të cilin kishte punuar edhe dëshmitari me nënën e tij për dy apo tri vite, por pas ndërprerjes në mënyrë të vullnetshme së bashkëpunimit me A...in, është shfaqur një mik i A...t që ka ardh dhe ka deklaruar që A... I ka borgj një shumë të caktuar të të hollave dhe ka thënë se ka ndëgjuar se prindi im dhe A... janë në përfundim te ortakërisë dhe i ka thënë prindit qe një makinë e punës që ka qenë aty në fabrikë, mos e prekni se ajo realisht I takon ati. Pastaj, në pyetjet e prindit tim, A... e pranon se ka obligim ndaj këtij personi (duke ju referuar të pandehurit Sh...) e për të cilin borgj prindi I tij, tani I dëmtuar nuk kishte ditur, dhe sqaron se për këto informata, përveq që I ka treguar prindi I tij, I ka kuptuar edhe nga biseda direkte që ka pas me A...n dhe Sh...n.Dëshmitari Q..., pranon se pas kësaj është e vërtetë që ka patur takime me muaj të tërë me A...n dhe Sh...n për të arritur marrëveshje, por që të njëjtat nuk janë zbatuar. Pohon se Sh... e kishte lutur dëshmitarin që të gjej ndonjë object tjetër, me arsyetimin se ai (Sh...) ishte duke paguar qira për objektet ku operonte kompania e re. I njëjti në dëshminë e tij poashtu thekson se përkundër presionit, nuk ka ndodhur ortakëria e dhunshme, edhepse është tentuar, por që në fillim të pandemisë janë detyruar që të investojnë në një objekt të ri në Ferizaj për të liruar objektin. I njëjti më tutje ka shtuar se I tërë presioni që I është bërë prindit të tij, ka patur për qëllim që t’a pranojë Sh...n si ortak, dhe format e presionit i vlerëson fjalët e të pandehurit Sh... “ a mi ke renit puntoret te puna,kam me ti terhek makinat me bager, kam ardhur me vëllezër jam tu prit te Sh... (referuar pompës derivateve ne Han te Elezit), telefonatae A...t me 31.12.2019 ku ka thene “lemi qelsat se jam te pru do lëndë të parë në fabrikë” dhe sqaron se te

nesërmen me 01.01.2020 pasi që kanë mbajtur një takim me A...n dhe Sh...n, është vërtetuar se, kanë patur kohë për zhvendosje nga fabrika deri me dt.31.01.2020. Dëshmitari thekson se ka qenë bashkë me prindin kur është bërë telefonata e dt.31.12.2019 dhe e njëjta ka qenë kërcënuese, për faktin se A...i I ka kërkuar çelësat e biznesit me fillu punën pa dëshirën e prindit tim, I njëjti poashtu ka sqaruar se, fillimisht ka qenë marrëveshja, për të punuar 3 ditë me tri për secilin, por pastaj ka qenë pamundësi e ushtrimit të punëve në fabrikë mirpo për shkak të ndodhjeve të telefonatave e presioneve të panevojshme u pa që kjo nuk ka funksionu edhe pse ka qenë opsioni I tij. Kjo edhe për faktin se prindi I tij Nafiu, nuk pranoi në mënyrën dhe format ashtu siq A...i mendonte t'a zbatonte propozimin e tij, dhe edhe pse "..." ka patur kontratë për qira në atë objekt deri në vitin 2025, megjithatë kjo kontratë është prishur para kohe. Dëshmitari me tutje ka theksuar se është biseduar që I pandehuri Sh... të jetë ortak si pjesë e e kësaj të fabrikës. Dëshmitari Q..., duke sqaruar rastin e dt.27.01.2020, thekson se I njëjti ka qenë rrugës tu shkuar prej Ferizaj në drejtim të Hani Elezi, kur e kishte telefonuar prindi I tij dhe I kishte treguar se konkretisht Sh... I kishte thënë se a je ti heq makinat a te vi me ti heq me bager dhe dëshmitari I kishte thënë prindit të tij N..., që rastin t'a lajmërojë në Polici, dhe pastaj dëshmitari ka shkuar te fabrika, ku ka ardhur edhe Sh... dhe gjatë bisedës rreth këtij problem, e kanë thirrur policia.

Dëshmitarja M.G., në dëshminë e saj në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se si në çdo rast tjetër që paraqitet në Stacionin Policor në Hani Elezit, patrulla policore ka përpiluar raportin I cili është dërguar në njësitin e hetimeve ku edhe ka punuar dëshmitarja, është caktuar polici hetues, I cili në konsultim me prokurorin e shtetit ka marrë veprimet e mëtutjeshme hetimore. I kujtohet që e ka intervistuar të pandehurin Sh... dhe pastaj ka përpiluar kallëzimin penal.

Nga këto dëshmi, gjykata vërtetoi se disa ditë pas arritjes së marrëveshjes mbi ndarjes e aseteve të Ndërmarrjes të "..." me dt.06.09.2019, në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit A..., në zyrën e të dëmtuarit kishte shkuar I pandehuri Sh..., ku prezent ka qenë edhe I pandehuri A..., dhe pasi që i pandehuri Sh..., nga qanta e tij e krahuat nxjerr një revole në tavolinë, i drejtohet të dëmtuarit N.B me fjalët "kam ndërgjuar nga ky zotëria, (duke aluduar në të pandehurin A...) se jeni në procesin e ndarjes, ky zotëria A..., me ka marrë parë borgj 50.000 € dhe duke e drejtuar gishtin nga njëra nga makinat në fabrikë, thot se qajo maqina e cila e ka vlerën 60.000 €, është e jemja dhe mos gaboj me prek", ndërsa me dt.27.01.2020 i pandehuri Sh..., përmes telefonit me nr.049/122-100, e thërret të dëmtuarin N.B, dhe i thot: "a i ke mbledh puntortë te fabrika, se unë du mi pa aty dhe zyrën tënde aty në fabrikë me ma liru, ose vij me bager ti nxjerri maqinat, se s'ja ke ble ti maqinat A.J" dhe kërkon që të jetë prezent sa herë që i dëmtuari të bisedojë me të pandehurin A..., derisa me dt.01.02.2020, pasi që i dëmtuari i kishte dërguar shkresën për marrëveshje të pandehurit A..., i pandehuri Sh... ishte shprehur ndaj të dëmtuarit me fjalët "unë vendosi për këtë punë, dhe me dt.01.02.2020 bëhem ortak me juve, dashte ti apo nuk dashte". Ndërsa i pandehuri A... me dt.31.12.2019, përmes telefonit e kishte kontaktuar të dëmtuarin N.B, duke i thënë me ton urdhërues "lemi qelsat në fabrikë se kam me pru do landë të parë aty" edhe

pse me marrëveshje me shkrim, i pandehuri A... dhe i dëmtuari, ishin pajtuar që nëse të dëmtuarit i paraqitet ndonjë problem teknik rreth tërheqjes së mjeteve nga fabrika në fsh.Seqishtë, të dëmtuarit t'i ipet afat afat shtesë, pra për tërheqjen e mjeteve të punës nga fabrika.

Kjo pasi që në rastin konkret nuk ishte kontestuese se i pandehuri Sh..., disa ditë pas arritjes së marrëveshjes për ndarjen e aseteve mes të dëmtuarit dhe të pandehurit A..., kishte shkuar në zyrën e të dëmtuarit ku prezent kishte qenë edhe i pandehuri A..., nuk ishte kontestuese se i pandehuri Sh... me dt.27.01.2020 e kishte thirr në telefon të dëmtuarin , dhe nuk ishte kontestuese se i pandehuri A..., me dt.31.12.2019 e kishte thirr ne telefon të dëmtuarin, duke kërkuar nga ky i fundit që t'a lirojë fabrikën, meqë këto vërtetohen edhe nga vetë deklaratimet e të pandehurve, por kontestuese ka qenë fakti që nëse i pandehuri Sh... kur kishte shkuar në zyrën e të dëmtuarit, disa ditë pas arritjes së marrëveshjes së dt.06.09.2019, a e kishte nxjerr revolen nga qanta dhe a është shprehur me fjalët “ kam ndëgjuar nga ky zotëria, (duke aluduar në të pandehurin A...) se jeni në procesin e ndarjes, ky zotëria A..., me ka marrë pare borgj 50.000 € dhe duke e drejtuar gishtin nga njëra nga makinat në fabrikë, thot se qajo maqina e cila e ka vlerën 60.000 €, është e jemja dhe mos gabo me prek”, fakti që i pandehuri Sh... , përmes telefonatës së dt.27.01.2020 ndaj të të dëmtuarit ishte shprehur me fjalët “a i ke mbledh punëtortë te fabrika, se unë du mi pa aty dhe zyrën tënde aty në fabrikë me ma liru, ose vij me bager ti nxjerri maqinat, se s'ja ke ble ti maqinat A.Jt”, fakti që pastaj pasi që janë takuar te fabrika në fjalë i pandehuri Sh... ishte shprehur ndaj të dëmtuarit me fjalët” unë vendosi për këtë punë, dhe me dt.01.02.2020 bëhem ortak me juve, dashte ti apo nuk dashte”.

Me rastin e shyrqimit të faktit të parë kontestues (sipas radhitjes si më lartë) , gjykata pati parasysh deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në cilësi të dëshmitarit, i cili ndër të tjera ka theksuar se, ka qenë pretendim I Sh...t dhe A...t, që Sh... të hyjë si ortak në kompaninë e tyre, mirpo edhe përkundër saj nuk e ka pranuar si ortak Sh...n dhe as që ka qenë temë kjo, edhe pse Sh... kishte shkuar dy-tri here në fabrikë, I paftuar, me një qantë në krah duke e qel dhe treguar se ka diqka aty, për të dëmtuarin kjo ka qenë kërcënuese. Ka pranuar si të sakta fjalët e thëna në prokurori si në vijim “ Me kujtohet se Sh... e ka pasur nje qante te mesme krahu nga e cila ka nxjerr nje revole ne ate raste me ka thene se kam dëgjuar se je ne procesin e ndarjes ky zotria A... me ka marr oare borgj 50 mijë dhe se ajo maqina e ka vlerën 60 mijë €, është e jemja dhe mos gabo me prek”. Me rastin e shyrqimit të faktit të dytë kontestues, gjykata poashtu pati parasysh deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në cilësi të dëshmitarit pranë kësaj gjykate përmes të cilës ka sqaruar se I pandehuri Sh... me dt.27.01.2020 e kishte thirr në telefon dhe ishte shprehur me fjalët “a i ke mbledh punëtortë te fabrika, se unë du mi pa aty dhe zyrën tënde aty në fabrikë me ma liru, ose vij me bager ti nxjerri maqinat, se s'ja ke ble ti maqinat A.Jt”.

Gjykata me rastin e vlerësimit të deklaratës së të dëmtuarit, të njëjtës i fali besimin, meqë e njëjta në mënyrë të hollësishme përshkruan rastet në vazhdimësi dhe se njëjta përveq që gjen mbështetje në tërësi

në deklarin e tij në prokurori dhe në deklarin e dëshmitarit Q. B. të dhënë para gjykatës dhe në prokurori, në provat materiale si, kontrata e dt. 06.09.2019 dhe dokumentet statuatore të fabrikës, pjesërisht gjen mbështetje edhe në vet deklarin e të pandehurit Sh..., i cili nuk e mohon faktin që disa ditë pas arritjes së marrëveshjes për ndarjen e aseteve, kishte shkuar disa herë në zyrën e të dëmtuarit, në periudhën kohore pas datës 06.09.2019 deri me dt.27.01.2020, edhe pse nuk ka pranuar se I ka thënë të dëmtuarit fjalët” kam ndëgjuar që jeni në procesin e ndarjes, ky zotrija A... me ka marrë borgj 50.000 €, e qajo maqina e ka vlerën 60.000 €, është e imja dhe mos gabo me prek”, por ka theksuar se dy makina që kanë qenë në fabrikë kanë qenë të tij, të cilat u’a kishte lënë në shfrytëzim të dëmtuarit dhe të pandehurit A..., si miq, pa kompenzim, prandaj është e logjikshme të pranohet nga gjykata se I pandehuri Sh..., duke pretenduar se dy makina të punës në fabrikë kanë qenë të tij, edhe I ka thënë të dëmtuarit fjalët kërcënuese si më lartë. Me rastin e vlerësimit të deklaratës së të dëmtuarit, gjykata poashtu pati parasysh, edhe deklarin e të pandehurit Sh..., I cili, u tha edhe më lartë, se kishte pranuar që me dt.27.01.2020 kishte biseduar në telefon me të dëmtuarin, por biseda sipas tij kishte të bëjë me pyetje rreth realizimit të marrëveshjes paraprake, duke I thënë se “a jeni duke e zbatu marrëveshjen a jeni duke i ndarë puntortë me A... ashtu siq jeni marrëveshje “ dhe sipas tij nuk ka qenë kërcënuese ashtu siq e paraqet I dëmtuari, dhe duke vlerësuar se meqë ka vepruar si ndërmjetës ka patur të drejtë për diqka të tillë, por që gjykata, bazuar në sjelljen e tij të mëparshme në zyrën e të dëmtuarit, pas datës 06.09.2019, dëshminë e dëshmitarit Q... dhe interesimin e tij (të pandehurit Sh...) për funksionimin e punës në një kompani në të cilën nuk ka patur ndonjë autorizim për të vepruar, dhe pretendimi I tij pronësor për dy makina të punës në fabrikë, dhe lajmërimi I policies po atë ditë nga I dëmtuari, lënë të kuptojnë që I pandehuri Sh... I ka përdorur fjalët e cekura si në dispozitiv me dt.27.01.2020 përmes telefonit, prandaj gjykata I fali besimin deklaratës së të dëmtuarit edhe për rastin e dt.27.01.2020, e për të njëjtat arsye I fali besimin edhe deklaratës së të dëmtuarit edhe për fjalët e të pandehurit që kanë të bëjnë me dt.01.02.2020.

Kurse sa I përket, deklaratës së të dëmtuarit lidhur me kërcënimin e të pandehurit A..., përmes telefonatës së dt.31.12.2019, gjykata pati parasysh se në kohën për të cilën bëhet fjalë, në fabrikë ka qenë duke operuar vetëm I dëmtuari, I cili edhe I ka patur qelësat e fabrikës deri në zhvendosjen e mejeteve të punës, në afatin e paraparë me marrëveshje të tyre, mirëpo I pandehuri A... edhe përkundër kësaj ka kërkuar nga I dëmtuari që t’I jape qelësat e fabrikës, për të dërguar lëndë të parë, jo në mënyrë kolegjiale, meqë ata më parë ishin edhe bashkëpunëtorë, por në mënyrë urdhëruese, prandaj gjykata, duke patur parasysh edhe deklarin e dëshmitarit Q... , I cili ka qenë me të dëmtuarin kur është bërë telefonata në fjalë, dhe duke patur parasysh raportet e tyre jo të mira kolegjiale, ku për pasojë edhe është bërë ndërprerja e bashkëpunimit afarist, I fali besimin deklaratës së të dëmtuarit edhe për faktin që kjo telefonatë nga I pandehuri A... ka qenë një formë presioni ndaj tij, për t’u zhvendosur edhe para afatit të paraparë me marrëveshja, nga fabrika në fjalë.

Fakte të njejta, si me deklaratën e të dëmtuarit, u vërtetuan edhe me deklaratën e dëshmitarit Q..., meqë I njejti poashtu në mënyrë kronologjike e ka përshkruar rastet e përshkruara si në aktakuzë dhe e njejta gjen mbështetje edhe në deklaratën e të dëmtuarit por pjesërisht edhe në deklaratat e të pandehurve, por edhe në provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Gjykata vlerësoi edhe deklaratën e dëshmitares M. G., e cila në dëshminë e saj ka treguar procedurën e ndjekur në Stacionin Policor ku ajo shërben, lidhur me rastin konkret, prandaj edhe dëshmisë së saj gjykata I fali besimin meqë e njejta gjen mbështetje edhe në vet kallëzimin penal të bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Kurse sa I përket kontratës së datës 06.09.2019 mbi ndarjes e asetëve të Ndërmarrjes të “...” e noterizuar me vërtetimin ... në zyrën e S. Sh., gjykata vërtetoi faktin se në subjektin afarist “...” kanë qenë bashkëpronarë, deri me dt.06.09.2019, vetëm I dëmtuari dhe I pandehuri A..., dhe poashtu edhe faktin se palët ishin dakorduar që deri në momentin e rregullimit të tërë dokumentacionit, për ndarjen e punëve, secili prej tyre, I dëmtuari dhe I pandehuri A..., të punojnë secili veq e veq në tri ditë të javës, fakt ky I cekur disa here edhe nga vetë palët në procedure.

Se të pandehurit, pas dates 06.09.2019 kanë themeluar biznese të tyre të veqanta, vërtetohet edhe nga dokumentet statusore të bashkangjitura në shkresat e lëndës, si Statuti I...EXTRA SHPK I dt.30.08.2019, me themelues A.J dhe Sh... E..., me seli në fsh. ... –Hani Elezit, ku edhe ka funksionuar më pare ... SHPK, vendimi për ndryshimin e emerit biznesit dhe emrit tregtar nga “... SHPK në EXTRA... SHPK, të dt.24.12.2019, dhe kërkesa për hapjen e llogarisë tatimore nga tatimpaguesi “... SHPK” të dt.14.01.2020.

Fakti që I pandehuri Sh... dhe dëshmitari Q..., kanë komunikuar disa here për të ndërmjetësuar në zbatimin e marrëveshjes në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit A..., përveq nga mesazhet telefonike, konfirmohet edhe nga vetë dëshmitari Q..., I cili megjithate e sheh si gabim dhënien e mundësisë të pandehurit Sh... për komunikim për zgjidhjen e problemeve në fabrikë, ku bashkëpronarë kanë qenë vetëm I dëmtuari dhe I pandehuri A..., por për të mos u krijuar ndonjë problem tjetër, dhe për t’I ndihmuar prindin e tij, dëshmitari Q... ka komunikuar me të pandehurin Sh... dhe A... veqmas e pastaj edhe me prindin e tij.

Gjykata, vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit Sh..., përmes së cilës I njejti thekson se në asnjë moment nuk është shprehur me fjalët e përshkruara si në dispozitiv, por përkundrazi, I autorizuar edhe nga vetë I dëmtuari, është interesuar për zbatimin e marrëveshjes së dt.06.09.2019, dhe arsyetimin e mbrojtjes se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, me asnjë prove të vetme nuk është vërtetuar se I mbrojturi I tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, meqë edhe nga vetë deklarimi I të dëmtuarit N.B, vërehet se ky I fundit nuk ka përfillur fjalët e të mbrojturit të tij, duke u përgjigjur,

se I kishte thënë të pandehurit Sh... “ t’I nuk ke asnjë të drejtë këtu me u përzi” tregon se në rastin konkret nuk ka asnjë formë të detyrimit dhe poashtu për faktin se lidhur me pretendimit e të dëmtuarit se I pandehuri Sh... ka kërkuar që të hyjë si ortak I dhunshëm në kompaninë ku N...dhe A... kanë qenë bashkëpronarë, I dëmtuari në pyetjen e prokurores ka theksuar se “ka qenë pretendim I tyre, pra Sh...t dhe A..., mirëpo nuk e ka pranuar si ortak Sh...n në kompani dhe as që ka qenë temë kjo”shtrohet pyetja cili ka qenë detyrimi në këtë rast, duke patur parasysh edhe faktin që I dëmtuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në pyetjet e parashtruara, ka është përgjigjur se “jo absolut nuk I ka përfillur kërkesat e të pandehurit Sh..., sepse të gjitha marrëveshjet ne I kemi bërë me bashkëpronarin A...n”. Kurse sa I përket zhvendosjes në Ferizaj, mbrojtësi ka potencuar se, I dëmtuari edhe përkundër marrëveshjes , objektin e kishte mbajtur për gjashtë muaj, ani pse ishin marrë vesh për tre muaj, por edhe sikur nga I dëmtuari të ishte kërkuar që të zhvendosej më pare, kërkesa e tillë do të ishte legjitime.

Me rastin e vlerësimit të mbrojtjes së të pandehurit Sh... të dhënë personalisht dhe përmes mbrojtësit të tij me autorizim, gjykata pati parasysh faktin se, edhe përkundër faktit që I pandehuri Sh..., ka tentuar që të bëhet pjesë e zbatimit të marrëveshjes së dt.06.09.2019, I dëmtuari nuk ka lejuar bashkëpunimin me te, pra në të njëjtën objekt të fabrikës në fsh....-Hani Elezit, me arsyetimin se I pandehuri Sh... nuk ka qenë pjesë e kompanisë “...” , dhe kjo u dëshmuar nga provat personale të adminstruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e sidomos nga deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitarit Q..., prandaj edhe gjykata I fali besimin kësaj pjese të mbrojtjes por jo edhe pjesës tjetër të mbrojtjes në të cilën thuhet se I pandehuri Sh..., me rastin e takimeve me të dëmtuarin, asnjëherë nuk ka përdorur fjalët kërcënuese të përshkruara si në dispozitiv, meqë këto tani më u vërtetuan me deklaratën e të dëmtuarit dhe deklaratën e dëshmitarit Q...

Gjykata, vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit A..., përmes së cilës I njëjti thekson se pranon se me dt.31.12.2019 e kishte telefonuar N..., nga I cili kishte kërkuar që t’ a lirojë objektin dhe e kishte pyetur se a kishte arritur që t’I transferojë mjetet nga objekti I fabrikës në fsh... në Ferizaj, por kërkesën e tij nuk e konsideron kërcënuese, Nuk e mohon faktin se , në kohën pas arritjes së marrëveshjes se dt.06.09.2019, kur bëhej fjalë për punën tri ditë me tri për secilin, kanë kërkuar një zyre në fabrikë për te dhe të pandehurin Sh..., meqë ky I fundit I kishte dy makinat e lartëcekura në fabrikë dhe I kishin borgj 17.000 €, si dhe fjalën e mbrojtësit të tij, I cili ndër të tjera ka theksuar se nga provat e adminstruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua që I mbrojturi I tij e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, dhe kjo vërtetohet edhe nga vetë deklarimi I të dëmtuarit, I cili në asnjë moment nuk ka mundur që të vërtetojë që I pandehuri A..., e ka detyruar që të ndërmerri ndonjë veprim të caktuar nën detyrim, trysni apo kanosje, por të gjitha pretendimet e tij janë se supozuara.Sipas mbrojtjes, I dëmtuari ka folur për telefonatën e dt.31.12.2019 përmes të cilës pretendohet se I është thënë të dëmtuarit “sa më shpejt mi hjek maqinat se I kam puntë e mija”e që nga kjo nuk mund të arrihet në përfundim që ka patur detyrim nga I pandehuri A..., sepse me këtë ky I fundit vetëm ka

kërkuar që të zbatohet marrëveshja e lidhur mes tij dhe të dëmtuarit, për transferimin e mjeteve nga fabrika dhe kjo, bazuar në deklarinimin e të dëmtuarit, ka ndodhur rreth tetë muaj, dpasi që janë dakorduar për ndarjen e aseteve të kompanisë.

Me rastin e vlerësimit të mbrojtjes së të pandehurit A... të dhënë personalisht dhe përmes mbrojtësit të tij me autorizim, gjykata pati parasysh faktin se, I dëmtuari edhe përkundër kësa telefonate, të dt.31.12.2019, nuk është transefruar menjëherë nga objekti me qira I fabrikës në fsh., por janë takuar të nesermen dhe janë dakorduar që afati I zhvendosjes ka qenë me mundësi shtyerje, prandaj edhe I dëmtuari ka qëndruar në fabrikë edhe për rreth dy apo tre muaj, derisa I ka zhvendosur mjetet e punës nga objekti I fabrikës, prandaj argumentit të mbrojtjes se I pandehuri nuk është detyruar që të ndërmarrë ndonjë veprim të tij, pas kësa telefonate gjykata I fali besimin, meqë I dëmtuari pas telefonatës se dt së lartëcekur, u tha edhe më lartë, se janë dakorduar me të pandehurin A... për çështjen e shtyerjes së afatit të zhvendosjes se mjeteve nga fabrika, ndërsa mbrojtjes se të pandehurit, se deklarata e të pandehurit A...nuk ka qenë kërcënuese apo detyruese, gjykata nuk I fali besimin meqë, ka qenë I dëmtuari por edhe dëshmitari Q..., të cilët e kanë sqaruar presionin që I është shkaktuar të dëmtuarit nga telefonata në fjalë, dhe kjo bëhet edhe më e besueshme kur vetë I pandehuri A..., në fjalën e tij ka pranuar se kanë kërkuar një zyrë për të dhe të pandehurin Sh... ne objektin e fabrikës, në fsh,... – Hani Elezit, për të vazhduar me biznesin e tyre të ri që tashmë e kishin themeluar me të pandehurin Sh..., por me mjete të punës të subjektit afarist "...”Shpk, e të cilën gjë I dëmtuari nuk e kishte pranuar.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv, me të cilin rast gjykata bëri edhe rikalifikimin e kualifikimit juridik të veprës penale, nga veprën penale, Detyrimi nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, në veprën penale, Detyrimi në tentativë nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31, 77 dhe nenin 28 të KPRK-së, meqë nga të gjitha provate e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se të pandehurit, në bashkryerje, pas arritjes së marrëveshjes për ndarjen e aseteve të ndërmarrjes "...”të dt.06.09.2019, në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit A..., dhe pasi që kanë themeluar biznesin e tyre të ri "...”me seli në njëjtin vend , pra në fshatin ...-Hani Elezit, tentojnë që përmes presioneve të cekura si në dispozitiv, t’a detyrojnë të dëmtuarin që t’a pranojë të pandehurin Sh..., që të bashkëpunojnë bashkë në të njëjtin objekt, mirëpo i dëmtuari nuk ka pranuar që të bashkëpunojë me të pandehurin Sh..., derisa është tërhjekur nga objekti i fabrikës sipas marrëveshjes së arritur në mes tij si i dëmtuar dhe të pandehurit A..., me pjesëmarrje të edhe personave tjerë të përshkruar në marrëveshje si: H.M., M...,Q...dhe S...

Nisur nga të gjitha këto këto fakte te vërtetuara ne procedurë, gjykata vërtetoi se ne veprimet e te pandehurve, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale , Detyrimi në tentativë nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31, 77 dhe nenin 28 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që në rastin konkret si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se, bazuar në evidencën penale të kësaj gjykate, të njëjtit nuk evidentohen si kryes të ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata pati parasysh dëmin e shkaktuar të dëmtuarit nga tentimet e të pandehurve për detyrim dhe faktin se këto tentime kanë ndodhur në vazhdimësi, dhe jo vetëm njëherë të vetme.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurin Sh. E. dhe A.J, të akuzuar për veprën penale, Detyrimi në tentativë nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 31, 77 dhe nenin 28 të KPRK-së, i gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurve, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurve, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek të pandehurit dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhezimin e të dëmtuarit në contest civil për realizimin e dëmit, u mor konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 161/20 datë 22.02.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.